



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.22/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Musë Povataj dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbarimore, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija-Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesit të autorizuar të palës debitor, [REDACTED] /dhe përmbaruesi privat [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 12.10.2021, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-22/2021, datë 04.08.2021, dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës ankuese [REDACTED] të datës 04.08.2021, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, [REDACTED] nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 98/21.

A r s y e t i m

Me datën 03.08.2021, pala ankuese ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe ka propozuar të merren masa disiplinore ndaj përmbaruesit privat. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat [REDACTED] e ka lejuar përmbarimin sipas

propozimit për përbarim të paraqitur me dt 21.05.2021 nga pala kreditore “ [REDACTED] ”
Me datën 24.06.2021, pala debitore ka kuptuar që xhirollogaritë bankare i janë bllokuar dhe të njëjtat bazuar në informacionet nga bankat nuk ka mundësi që t’i shfrytëzojë për aktivitetin e vet tregtar. Pala ankuese thekson që pas komunikimit me përbaruesit privat, ka siguruar një kopje të dosjes ku vërehet se urdhëri përbarimor ishte dorëzuar në adresë të gabuar. Edhe pse përbaruesi privat i ka mundësuar palës ankuese ushtrimin e prapësimit, i njëjti nuk ka debllokuar xhirollogaritë bankare. Shton se përbaruesi provat ka lejuar përbarimin mbi bazën e faturës pa u siguruar se pala debitore kishte pranuar të njëjtën në mënyrë të rregullt. Pala ankuese pretendon që fatura si në shkresat e lëndës, është rezultat i falsifikimit nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar asnjëherë nga pala debitore, dhe për këtë është iniciuar rast penal në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Me datën 04.08.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përbaruesit privat [REDACTED], si organ përbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 të Ligjit për Procedurën Përbarimore lidhur me nenin 114 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjatë ndërmarrjes së veprimeve përbarimore nga ana e përbaruesit privat në lëndën P. nr 98/21.

Përbaruesi privat z. Ilmi Miftaraj në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Thekson se me dt 21.05.2021 ka lejuar përbarimin mbi bazën e propozimit të palës kreditore. Propozimi me dokumentet provuese, shtojcat dhe lejimin e përbarimit të propozuar i janë dërguar palës debitore përmes Postës sipas adresës së shënuar në propozimin për përbarim, siç edhe dëshmohet nga fletëdërgesa personale R: 1425907. Pas marrjes së përgjigjes nga zyrtarët e Postes se “pala është shpërngulur” ka ndërmarrë veprime ligjore në verifikimin e adresës së palës debitore në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) nga ky ka konstatuar se adresa zyrtare e debitorit ishte [REDACTED] objekti [REDACTED] Prishtinë. Me dt 02.06.2021, përbaruesi privat thekson se ka dorëzuar shkresat e lëndës përmes Postës së Kosovës në adresën e palës debitore siç dëshmohet me fletë dërgesën R: 1425921, megjithatë përsëri kanë pranuar përgjigjen nga Posta se “pala është shpërngulur”. Me dt 11.06.2021, përbaruesi privat, thekson se ka nxjerrë konkluzion për vendosjen e shkresave në Tabelën e Shpalljeve, të cilat kanë qëndruar nga data 11.06.2021 deri më dt 18.06.2021. Pas kalimit të afatit, përbaruesi privat thekson se me dt 21.06.2021, janë tërhequr shkresat nga Tabela e Shpalljes. Shton se pasi që urdhëri për lejimin e përbarimit të propozuar është bërë i formës së prerë, ai ka ndërmarrë veprime ligjor ashtu që ka bërë bllokimin e llogarive bankare. Thekson se me dt 28.06.2021 debitore së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor kanë kërkuar shpjegime në Zyrën e Përbaruesit Privat dhe atyre iu është dhënë një kopje komplete e shkresave të lëndës përbarimore si dhe janë udhëzuar lidhur me mjetet juridike në dispozicion - prapësimin dhe kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, të cilat mund t’i ushtrojnë në adresimin e pretendimeve të tyre në Gjykatën kompetente. Pala debitore ka ushtruar të dy mjetet juridike dhe shkresat e lëndës janë përcjellë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Rrjedhimisht, përbaruesi privat propozon që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Me datën 12.10.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lira-Divizioni

për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija-Kërveshi në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese [redacted] dhe përmbarruesi privat, [redacted]

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija-Kërveshi, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesi e palës ankuese ka ngelur pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë elaborimin e saj. Përmbarruesi privat gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përmbarruesi nuk ka kryer veprë disiplinore.

Për sa i përket dorëzimit të shkresave të lëndës, Komisioni Disiplinor gjen se përmbarruesi privat [redacted] përmes Shërbimit Postar kishte dërguar shkresat palës debitore në adresën e ofruar nga pala kreditore rrug: [redacted] objekti 2/2, në [redacted] Megjithatë, siç evidentohet nga fletë dërgesa personale R: 1425907, dt 21.05.2021, përmbarruesi privat është njoftuar prej Shërbimit Postar të Kosovës që “marrësi është shpërngulur” nga kjo adresë. Përmbarruesi privat kishte ndërmarrë veprime shteruese për të siguruar informacione për adresën e saktë të palës ankuese duke kontrolluar të dhënat lidhur me adresën e palës ankuese edhe në ARBK dhe Regjistrin e Llogarive Bankare dhe, nga këto burime të informimit, kishte rezultuar se adresa e saktë e palës debitore është [redacted], objekti [redacted] në [redacted]. Përmbarruesi privat kishte përsëritur dërgesën e shkresave saktësisht në adresën e palës debitore të cilën kishte arritur ta siguronte nga të dhënat në ARBK, siç edhe evidentohet nga dërgesa personale R: 1425921, dt 02.06.2021. Megjithatë, përmbarruesi privat përsëri ishte njoftuar nga zyrtarët e Postës së Kosovës që “marrësi është shpërngulur.” Komisioni Disiplinor gjen se informacionet e ofruara nga Posta e Kosovës se pala “është shpërngulur” ishin zyrtare dhe ishin të besueshme. Fakti se rrugët nuk përmbajnë emra dhe numra të saktë të adresave, nuk mund t’i atribuohen përmbarruesit privat si lëshime. Vetëm pasi gjitha përpjekjet e përmbarruesit privat kishin rezultuar të pasuksesshme përmbarruesi privat kishte bërë afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e tij. Komisioni gjen se veprimet e përmbarruesit privat [redacted] shin plotësisht në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore.

Për sa i përket asaj se faturat nuk janë pranuar nga debitori apo se ato janë eventualisht të falsifikuara nga ana e palës kreditore, Përmbarruesi privat i ka siguruar dokumentacionin palës ankuese në momentin që pala ishte paraqitur dhe kishte kërkuar atë. Pala ankuese kishte mundësi të ushtronte prapësim dhe mjetet tjera juridike nëse konsideronte që të drejtat e tij ishin afektuar në ndonjë mënyrë nga veprimet e përmbarruesit privat, të cilën edhe e ka bërë. Madje, siç e thekson edhe vet pala ankuese është ngritur edhe një kallëzim penal dhe organet përgjegjëse do ta trajtojnë atë. Mandati i Komisioni Disiplinor është i kufizuar, Komisioni Disiplinor nuk është i thirrur të zbatojë procedura hetimore penale. Është në kompetencën e gjykatave dhe organet kompetente ligj

zbatuese të vendosin lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e palës ankuese përkitazi me falsifikimin e dokumentacioneve.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 22/2021, datë 12.10.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.